



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E DREJTA E UNIONIT EVROPIAN

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta e Unionit Evropian
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i 3-të, semestri i 6-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Ligjërata: Ushtrime:
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka Asistent: Mr. Sc. Rilind Berisha
Detajet kontaktuese:	Email: dukagjin.leka@gmail.com & berisharilind@gmail.com Cel: +383 (0) 44 211 671 & +377 (0) 44 785 857
Përshkrimi i lëndës	E Drejta e Unionit Evropian, si një ndër lëndët më të rëndësishme për studimet në drejtësi, ka një dinamikë tejet të shpejtë të zhvillimit. Si e tillë, lënda mbi të Drejtën e Unionit Evropian sjell risitë e saj gjatë evolucionit dhe ngritjes së saj si disiplinë shkencore. Megjithatë kjo lëndë ka si qëllim parësor, ofrimin për studentë të njohurive të përgjithshme dhe atyre konceptuale mbi të Drejtën e Unionit Evropian. Në këtë kuadër, lënda e së Drejtës së UE-së do t'u ofrojë studentëve mundësi që t'i zhvillojnë njohuritë e tyre mbi sistemin juridik të Unionit Evropian dhe mënyrën e funksionimit të tij. Konsideratë të veçantë do t'i jepet Traktateve Themeluese të Komuniteteve të Para që shërbyen si bazë për themelimin e mëvonshëm të vet UE-së. Në këtë kontekst, studentët së pari do të ballafaqohen me aktet themeluese, si burime primare të së drejtës së Unionit Evropian, mbi të cilat jo vetëm që është themeluar kjo organizatë por, edhe shërbejnë si bazë kryesore për funksionimin dhe avancimin e rolit të saj në arenën ndërkombëtare. Më pas, përqendrimi do të jetë në burimet sekondare të Unionit Evropian, të

	cilat së bashku me burimet primare formojnë sistemin e normave juridike apo atë sistem të rregullave norma-vënëse, i cili njihet si i ashtuquajturi <u>acquis communautaire</u>. Si pjesë e kësaj lënde do të shqyrtohet origjina dhe evolucioni i një prej organizatave më të shënuara dhe/ose komplekse ndërkombëtare që njihet sot në botë-Unioni Evropian. Burimet e kësaj të drejte, si ato primare dhe sekondare, janë gjithashtu, pjesë e domosdoshme e njohurive të para me të cilat studentët duhet të pajisen, duke vazhduar më pas edhe me institucionet themelore, procedurat e tyre të vendimmarrjes si dhe kompetencat e tyre, prej të cilave një vëmendje e posaçme do t'i kushtohet Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe rolit të saj unik në krijimin e vet të Drejtës së UE-së. Ky rol i Gjykatës do paraqitet nëpërmjet tërësisë së rasteve të paraqitura dhe vendimeve të marra prej saj qoftë nëpërmjet vet praktikës klasike gjyqësore qoftë edhe me anë të interpretimit të legjislacionit primar dhe sekondar përmes të ashtuquajturës procedurë preliminare. Përveç për burimet primare dhe sekondare, studentëve njëkohësisht do tu ofrohen njohuri të përgjithshme lidhur me Kartën e të Drejtave Themelore të UE-së, karakteristikat themelore të saj si dhe dallimet dhe ngjashmëritë me aktet juridike të natyrës së ngjashme. Karta ka fuqinë juridike të njëjtë me atë të traktateve përkatësisht të Traktatit të Lisbonës. Institucioni përgjegjës për zbatimin uniform të kësaj karte është Gjykata e Drejtësisë së UE-së. Zhvillimi i kësaj organizate prej një Komuniteti Ekonomik Evropian e deri në një organizatë që përfshihen në një bashkëpunim të ngushtë ekonomik, duke u shtrirë kështu më tej në një bashkëpunim ndërqeveritarë në fushën e policisë dhe gjyqësisë për çështjet penale e atë të punëve të jashtme, paraqet një ndër zhvillimet më të mahnitshme të bashkëpunimit në mes shteteve bashkëkohore. Gjithashtu, roli i Unionit Evropian dhe sfidat e tij të brendshme rreth ndikimit në politikën botërore, do t'u mundësojë studentëve të krijojnë një vizion të përgjithshëm rreth dinamikës së marrëdhënieve ndërkombëtare në kohën e globalizimit. Tregu i brendshëm i UE-së do të jetë pjesë përbërëse e kësaj lënde gjithashtu. Kjo pjesë shqyrton substancën e projektit evropian, i cili mbështetet në pjesën më të madhe të tij në një projekt të integritetit ekonomik. Kjo lëndë do të përqendrohet në liritë themelore të tregut të brendshëm në përgjithësi: lëvizjen e lirë të mallrave (kufizimet sasiore dhe cilësore në tregti), personave, shërbimeve, kapitalit (dhe tregun financiar të integruar), e drejta themeltare në dritën e jurisprudencës të GJED dhe Unionin Monetar Evropian dhe menaxhimin sovran të krizave (rastet në Eurozonë me pikënisje Greqinë). Gjithashtu studentëve do tu ofrohen njohuri sa i përket zgjerimit të UE-së, fazave të zgjerimit, sfidave që kanë përcjellë këtë
--	---

	proces qofshin ato të karakterit substancial apo me pak substancial. Pastaj kriteret formale për anëtarësim në Unionin Evropian, karakteri i përgjithshëm i tyre, sfidat e përmbushjes së këtyre kriterëve nga vendet aspirante. Përveç kriterëve formale për anëtarësim ekzistojnë edhe kriteret jo formale të cilat nuk janë kritere që u adresohen vendeve anëtare por me tepër janë kritere të brendshme të UE-së. Si pjesë e përmbylljes së kësaj lënde, studentëve do t'u ofrohet mundësia që të zhvillojnë njohuritë mbi proceset e integritimeve evropiane dhe marrëdhëniet e Unionit Evropian me Ballkanin Perëndimor nëpërmjet Procesit të Stabilizim-Asociimit. Kjo pjesë e lëndës do t'u mundësojë studentëve të fokusohen edhe mbi sfidat praktike me të cilat ballafaqohet Ballkani Perëndimor në përgjithësi dhe Republika e Kosovës në veçanti në reformimin e sistemeve të brendshme në mënyrë që të përparojnë në rrugën e tyre drejt integritimeve evropiane. Përgjatë gjithë semestrit dhe shtjellimit të aspekteve të mësipërme, do të ofrohen ndryshimet më të reja të sjella me vet Traktatin e Lisbonës. Pra ky Traktat do shërbejë si pikë referuese për të tërhequr trajektoret krahasuese mbi ndryshimet e sjella në secilën fushë të trajtuar.
Qëllimet e lëndës:	Duke pasur parasysh rolin e së Drejtës së Unionit Evropian, si një e drejtë në mes së drejtës ndërkombëtare dhe së drejtës së mbrendshme, si dhe duke parë që roli i Unionit Evropian, që nga krijimi i tij, e sidomos në fundvitet e shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI është duke u rritur jo vetëm në Evropë, por edhe më gjerë, fare lehtë mund të konkludohet se nevoja për një lëndë të tillë për tu studiuar është shumë e madhe, e sidomos për studentët e fakultetit juridik, pasi që sot Unioni Evropian ka arritur pothuajse në kulminacionin e procesit të integritimit, duke u bërë kështu një organizatë regjionale supranacionale, me karakteristika sui-generis të funksionimit të saj. Për këtë arsye sot shumica e universiteteve të njohura ndërkombëtare në botë kanë lëndën E Drejta e Unionit Evropian, si lëndë të veçantë, prandaj edhe ne si Fakultet Juridik i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan nuk mund të bëjmë një përjashtim dhe e kemi parë mëse të nevojshme që kjo lëndë të futet në kurrikulën mësimore të Fakultetit Juridik, Universiteti “Kadri Zeka” në Gjiilan. E Drejta e Unionit Evropian është një lëndë sfiduese pasi operon në një arenë politike dhe ekonomike që për nga struktura dhe dinamika dallon nga e arena e brendshme e shteteve me të cilën studentët janë më të familjarizuar.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të: - Të njohin, kuptojnë dhe shpjegojnë strukturën institucionale të

	Unionit Evropian, duke përfshirë edhe institucionet që kanë lindur me marrëveshjet e para historike të vetë kësaj organizate; - Që të kuptojnë dhe shpjegojnë konceptet themelore të së Drejtës së UE-së, strukturën ligjore, vendim-marrjen dhe burimet e së drejtës së UE-së; - Që të kuptojnë dhe shpjegojnë funksionin e Gjykatës së Drejtësisë së UE-së, e në veçanti, raportit ndërmjet të Drejtës së UE-së dhe të Drejtës kombëtare të shteteve anëtare të UE-së, si dhe vetë efektet e së Drejtës së UE-së në vetë organizatën dhe shtetet anëtare të saj; - Që të kuptojnë dhe shpjegojnë tregun e brendshëm dhe liritë themelore të tij; - Që të kuptojnë dhe shpjegojnë gjithashtu edhe Kartën e të drejtave themelore të UE-së, si një prej dokumenteve kryesore për të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të UE-së; - Që të kuptojnë dhe shpjegojnë procesin e zgjerimit të UE-së dhe kriteret e anëtarësimit në UE, relacionet e UE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe krejt në fund gjithashtu edhe vetë relacionet e Republikës së Kosovës me UE-në.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	Javë	4
Ushtrime teorike/laboratorike	1	Javë	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	Javë	2
Kollokfiume,seminare	2 Kollokfiume 1 Punim për Studentë	Javë	2
Detyra të shtëpisë	10	Javë	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)			
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e	Kjo lëndë ndër të tjera ofron një qasje inovative sa i takon		

mësimdhënies:	mësimdhënies për të Drejtën e Unionit Evropian. Në vend të mësimdhënies si doktrinë sistematike, ne do të punojmë me një mori problemesh të dizajnuara për të përcjellë njohuritë bazë në mënyrë dinamike, realiste dhe komparative. Metodot akademike janë të ndryshueshme dhe janë sfidë e veçantë. Përqendrimi në mendimin kritik, analitik dhe kreativ do të jetë filozofia bazë e organizimit dhe mbarëvajtjes së kësaj lënde. Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet diskutimit dhe pjesëmarrjes aktive të studentëve gjatë orëve të mbajtjes së kësaj lënde. Metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret në zbatimin e programit të kësaj lënde mbështetet në analizën e thellë të materialeve të përzgjedhura. Studentët duhet të ballafaqohen me problemet e jetës së përditshme të hulumtimit dhe interpretimit, të zgjedhura midis atyre më të shpeshta dhe tipike në proceset vendimmarrëse dhe të ligj-bërjes ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, me prioritet ndaj atyre që kanë ose mund të kenë një korrelacion më të përafërt me përvojat dhe nevojat në Kosovë. Me fjalë të tjera, nuk do të prezantohen vetëm rregullat themelore në burimet e përshkruara, por problemet më të shpeshta që shfaqen gjatë aplikimit të tyre, për të ndriçuar strukturën e tyre dhe problemet interpretuese që lidhen me to. Do të bëhet, gjithashtu, përpjekje për një ekuilibrim të përhapjes së njohurisë mbi tiparet kryesore të sistemit institucional ndërkombëtar dhe nocioneve më të specializuara, ndonëse orientimi parësor do të jetë i motivuar nga filozofia udhëheqëse, në këtë rast njohuria bazë mund të përftohet lehtë si derivat i diskutimit të përqendruar në probleme të specializuara, përparësia e të cilës empirikisht qëndron në një shkallë më të lartë probabiliteti të ngritjes apo rritjes së aftësisë ose shkathtësisë dhe kapacitetit për të zotëruar nocione më specifike dhe për të vepruar në kontekste më praktike. Pastaj metodat e tjera bashkëkohore, të cilat do të përdoren gjatë procesit të mësim-dhënies dhe mësim-nxënies do të jenë edhe metodat interaktive, përmes pyetjeve dhe përgjigjeve, ndarja në grupe të vogla diskutuese, përmes prezantimeve, punimeve seminarike, testeve provuese, pregaditjes së rasteve të ndryshme për studim, analizimi i rasteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si në aspektin e mbrendshëm, poashtu edhe në aspektin ndërkombëtar, etj.
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 30 pikë Testi i dytë: 40 pikë Detyrat e shtëpisë: 20 pikë (1 detyra – punim seminarial x 20 pikë – obligative për notën 9 dhe 10) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Totali: 100 pikë. Provimi përfundimtar: 100 pikë

	Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	➤ Blerim Reka & Ylber Sela: E Drejta e Unionit Evropian; ➤ Paskal Milo, “Bashkimi Evropian” (Ideja, Integrimi, Identiteti, e Ardhmja), Tiranë 2002.
Literatura shtesë:	➤ Anthony Luzzatto Gardner and Stuart E. Eizenstat, New Treaty New Influence: Europe’s Chance to Punch Its Weight, Foreign Affairs, March/April 2010 ➤ Tom Casier and Sophie Vanhoonacker (2007), 'The EU as a global player'. In: T. Blom (ed.), Reviewing Europe. Maastricht University Press, 107-138 ➤ Ulrike Guérot, “After Lisbon: Is Europe Becoming a Global Power?” Global Issues, 2010. ➤ Pedro Solbes and Richard Youngs, “Europe is failing to shape the Global Governance Debate” Europe’s World, Summer 2010. ➤ Pedro John Fairhurst, “Law of the European Union”, Seventh Edition 2010, British Library Cataloguing-in-Publication Data. ➤ Margot Horspool & Matthew Humphreys, “European Union Law” Oxford University Press, 2008, faqe 13-33. ➤ Erjona Canaj dhe Sokol Bana, “E Drejta e Bashkimit Evropian” Tiranë 2010, faqe 1-37. ➤ Ralph H. Folsom ”Principles of European Union Law” Second Edition 2009 Thomson Reuters, faqe 1-29. ➤ Paul Craig and Grainne DE Burca “ EU LAW- Text, Cases and materials” Fourth Edition, 2008 faqe 268-304. ➤ Tim Corthaud “Plus ça change, plus c’est la même chose: A Comparison of the Lisbon Treaty and the Constitutional Treaty” (2008). Maastricht Journal of European and Comparative Law (17). ➤ G de Búrca, The Lisbon Treaty No-Vote: An Irish Problem or a European Problem? (2009). ➤ Traktati mbi Unionin Evropian (TEU) dhe Traktati për Funksionimin e Unionin Evropian (TFEU). ➤ Diego Acosta “The Good, the Bad and the Ugly in EU Migration Law: Is the European Parliament Becoming Bad and Ugly? (2009) European Journal of Migration and Law ➤ Anton Bebler “Hyrje ne Integrimet Evropiane”, përkthyer nga Kolegji Universitar “Victory” Prishtinë, faqe 202-212. ➤ Caner Öinkel “The Eastern Enlargement of the European Union”, Lambert Academic Publishing 2009. ➤ Deirdre Curtin, “Executive Power of the European Union: Law, Practices, and the Living Constitution”, Oxford 2009, fq. 69-103.

	➤ Robert Soin, “Evropa Politike”, Tiranë 2008. ➤ Ueb-faqja e UE-së: http://europa.eu/index_en.htm ➤ Gjykata Evropiane e Drejtësisë (ECJ): http://curia.europa.eu/ ➤ EURLEX për legjislacionin e KE-së: http://europa.eu/documents/eur-lex/index_en.htm ➤ Traktatet e UE-së: http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/index.htm
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	HYRJE Prezentim i përmbajtjes së lëndës, metodave, organizimit dhe kërkesat e lëndës; Diskutime dhe sqarime për të gjitha çështjet që studentët mund ti preokupojnë e që kanë lidhje me lëndën.
<i>Java e dytë:</i>	HISTORIKU I UE-së, TRAKTATET THEMELTARE DHE AMENDAMENTUESE(PERIUDHA NGA ROMA DERI NE LISBONË) Kjo pjesë do të përfshij një informacion të përgjithshëm mbi themelimin e Bashkësive të para Evropiane (Bashkësia për thëngjill dhe Celik, Bashkësia Ekonomike Evropiane dhe Euroatomi), pastaj mbi themelimin e Unionit Evropian (traktati i Mاستrihtit 1993), Traktati i Amsterdimit, Nicës e deri të Traktati i Lisbonës. Përveç që do t'i casemi në aspektin historik këtyre traktatve, do të japim edhe një vështrim të shkurtër mbi qëllimin e nxjerrjes së tyre si dhe do të përmendim aspektet juridike më rëndësi të trajtuara/adresuar nga këto traktate. Traktati i Lisbonë do të shtjellohet më gjerësisht në një ligjeratë të veçantë në javët në vijim.
<i>Java e tretë:</i>	NOCIONI, KUPTIMI I TË DREJTËS SË UE-së, BURIMET PRIMARE DHE SEKONDARE, RELACIONI I TË DREJTËS SE UE-së ME TË DREJTAT E VENDEVE ANËTARE DHE TË DREJTËN NDERKOMBËTARE ZBATIMI I TË DREJTËS SË UE-së-PARIMI I EFEKTIT DIREKT DHE PARIMI I SUPREMACISË) DHE PARIMET E VEÇANTA TË SË DREJTËS SË UE-së Në këtë ligjeratë do të ipet një pasqyrë e përgjithshme që ndërlidhët drejtpërdrejtë më burimet e të Drejtës së UE-së ku në detaje do të flitet për burimet primare dhe sekondarë të UE-së duke elaboruar sëcilën nga ato përfshirë hierarkinë në mes tyre, efektin juridik etj. Pastaj

	do të bëhet një shpjegim i përgjithshëm sa i përket relacionit të së Drejtës së UE-së më të Drejtën e vendeve anëtare dhe të Drejtën Ndërkombëtare. Zbatimi i të Drejtës së UE-së, dhe parimet e kësaj të drejte do të shpjegohen në përgjithësi. Kurse parimi i efektit direkt dhe parimi i supremacisë shpjegohen më në detaje të ligjërata që do t'i kushtohet Gjykatës së drejtësisë së UE-së.
<i>Java e katërt:</i>	RATIFIKIMI I TRAKTATIT TE LISBONES, RISTITË/NDRYSHIMET QË KA SJELL KY TRAKTAT Kjo ligjeratë është vendosur në këtë pjesë të këtij planprogrami me qëllim që të shpjegohen rrethësi që ka sjellë Traktati i Lisbonës në përgjithësi për UE-në e në veçanti në strukturën institucionale dhe funksionimin e saj. Përveq tjerash këtu do të shtjellohen të gjitha ndryshimet dhe rrethësi më domethënëse që ka sjellë ky traktat për UE-në. Ndryshimet e sjalla nga ky traktat të përmendura në mënyrë të përgjithësuar në këtë pjesë do të konkretizohen në vazhdim të këtij planprogrami në ligjëratat e ardhshme.
<i>Java e pestë:</i>	STRUKTURA INSTITUCIONALE E UE-SË – KËSHILLI I UE-së, PARLAMENTI EVROPIAN, KOMISIONI, KËSHILLI I MINISTRAVE TË UE-së, BANKA QENDRORE EVROPIANE-ROLI, FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT E INSTITUCIONEVE TË UE-së Struktura institucionale e UE-së e ndryshuar dhe e avancur mjaftë shumë me Traktatin e Lisbonës tani do të shtjellohet në detaje duke filluar nga Këshilli i UE-së, Parlamenti Evropian, Këshilli i Ministrave të UE-së, Komisioni, Gjykata e Drejtësisë së UE-së, Banka Qendrore Evropiane e deri tek institucionet ndihmëse të quajtura kështu për shkak të funksionit që kanë. Ndryshimet të ka sjellë Traktati i Lisbonës përveq të manifestuara në strukturën institucionale njëkohësisht manifestohen edhe në funksionimin, përbërjen dhe kompetencat e këtyre institucioneve. Ndryshimi i kompetencave të këtyre institucioneve nuk është bërë substancialisht, por më tepër është theksuar në kuptim të zgjerimit të kompetencave. Gjykata e Drejtësisë së UE-së do të spjegohet në një ligjeratë të veçantë në ligjeratën e ardhshme.

Java e gjashtë:	GJYKATA E DREJTËSISË E UNIONIT EVROPIAN, JURISDIKSIONI, FUNKSIONI, KOMPETENCAT, RELACIONI ME GJYKATAT NACIONALE, ANALIZË E RASTEVE Kjo ligjëratë ofron një bazë të mjaftueshme për të kuptuar aplikimin dhe zbatimin e së Drejtës së UE-së në shtetet anëtare. Me tej shpjegon marrëdhëniet në mes të drejtës së UE dhe të drejtës nacionale të vendeve anëtare (<i>e drejta e UE-së paravlen dhe ka supremaci mbi të gjithë legjislacionin kombëtar</i>) dhe përshkruan dhe analizon parimet ligjore, parimin e efektit direkt dhe përgjegjësinë e shtetit të zhvilluar nga ana e Gjykatës së Drejtësisë për të lehtësuar zbatimin e ligjit, të drejtave të UE-së nga individët/personat fizik pranë gjykatave kombëtare, edhe kur shtetet anëtare kanë dështuar të inkorporojnë ose implementojnë parimet më të rëndësishme të dispozitave të së Drejtës së UE-së. Një rëndësi të veçantë do t'i jepet natyrës së funksionimit të UE-së si tërësi dhe praktikës gjyqësore dhe Gjykatës së Drejtësisë së UE-së (emërtimi zyrtar të cilin ia ka vënë Traktati i Lisbonës. <i>The Court of Justice of EU</i>). Jurisdiksioni i GJD pashmangshëm do të elaborohet. Praktika e saj, veç të tjerash, do të nis me shqyrtimin e rastit të famshëm, me nr. 26/62 <u>Van Gend en Loos</u> të v. 1963. Raporti ndërmjet të Drejtës së UE-së dhe të Drejtës nacionale. Rastet më të spikatura: 26/62, 41/74 & 152/84. Efekti jo horizontal i drejtpërdrejt i <u>Direktivave</u>; Parimi i përgjegjësisë së shtetit. <u>Supremacia e së Drejtës së UE-së</u>; Rastet: 6/64 – 106/77 – 213/89. Që të dyja së bashku, doktrina e efektit direkt dhe ajo e supremacisë (mbizotërimit) nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, janë parë si themelet e vizionit kushtetues klasik të rendit evropian ligjor. Janë perceptuar si pjesë e asaj që ka bërë Komuniteti Evropian (paraardhësi i Unionit Evropian), nisjes së vërtetë të një rendi të ri ligjor ndërkombëtar dhe një sistemi shumë efektiv dhe të integruar ligjor, i ndryshëm nga iniciativat e tjera shumë transnacionale ligjore (OKB ose OBT, ta zëmë).
Java e shtatë:	PROCEDURAT LEGJISLATIVE NË KUADËR TË UE-së: KONSULTIMI, BASHKËPUNIMI, BASHKËVENDIMI DHE PËLQIMI Institucionet e UE-së konform Traktatit të Lisbonës përveq që kanë kompetenca specifike dhe të veçanta në raportin mes tyre, të njëjtat kanë edhe funksione përkatësisht kompetenca thuajse të përbashkëta në kuptimin e krijimit të së drejtës posaqerisht Parlamenti i UE-së, Këshilli i Ministrave dhe Komisioni. Varësisht nga roli i Parlamentit të UE-së procedurat legislative të mësipërme

	marrin edhe emërtimin e tyre. Në këtë pjesë do të ipen shkurtimisht edhe rastet për të cilat përdoret njëra apo tjetra procedurë legislative.
<i>Java e tetë:</i>	TESTI MES-SEMESTRAL
<i>Java e nëntë:</i>	KARTA E TE DREJTAVE THEMELORE E UNIONIT EVROPIAN, FUQIA JURIDIKE, ZBATIMI I SAJ, DALLIMET DHE NGJASHMËRITË ME AKTET TJERA JURIDIKE NDERKOMBËTARE TË KËSAJ NATYRE Pjesë mjaftë më rëndësi në këtë planprogram do të jetë edhe ligjerata e paraparë për këtë javë e cila në mënyrë të detajuar do të ofroj njohuritë e nevojshme sa i përket Kartës së të drejtave themelore të UE-së. Do të bëhet një përshkrim dedikuar pikave lidhëse dhe ndarëse në përgjithësi sa i përket kësaj karte dhe akteve juridike ndërkombëtare të natyrës së njëjtë. Në mënyrë të veçantë do të trajtohet fuqia juridike e kartës, zbatimi i saj, respektimi nga vendet anaëtre të UE-se si dhe sfera rregullative e kësaj karte dhe vendi i saj në piramidën hirakike në raport më aktet e natyrës ngjashme.
<i>Java e dhjetë:</i>	TREGU I BRENDSHËM I UE-së, LIRITË THEMELORE TË TREGUT TË BRENDSHËM Kjo ligjeratë do të ofroj njohuri të përgjithshme që nga filltet e para të themelimit të tregut të brendshëm të UE-së, dhe në veçanti do të ofrohen njohuri specifike lidhur me liritë themelore të tregut të brendshëm si dhe për komponentët themelore të këtyre lirive.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	ZGJERIMI I UE-së, FAZAT E ZGJERIMIT-KRITERET FORMALE DHE JO FORMALE TË ANËTARËSIMIT NË UE Aspekti i zgjerimit të UE-së zënë një pjesë mjaftë më rëndësi në kuadër të këtij planprogrami. Ligjerata në fjalë do të japë informacionin shumë adekuat sa i përket fazave të zgjerimit të UE-së e deri të strategjia aktuale për zgjerimin e UE-së. Procesi i zgjerimit në kuptim të brendshëm quhet si tillë por në kuptimin e jashtëm apo të vendeve që aspirojnë për tu bërë pjesë e UE-së quhet si proces i anëtarësimit i cili është i përcjellur nga një vargë kriteresh të emërtuara si formale (të përcaktuara në Këshillin e Kopenhagës dhe Madridit) dhe jo formale (apo kritere të brendshme për vetë vendet anëtare) e të cilat në detaje do të shtjellohen në këtë pjesë të planprogramit.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	BALLKANI PËRENDIMOR DHE UE-ja, MARRËVËSHJA E STABILIZIM ASOCIMIT DHE LIBERALIZIMI I VIZAVE Samiti i Selanikut thajse hapur perspektiven e

	integriteteve evropiane për ballkanin përendimor. Me progresin e shënuar nga vendet e ballkanit përendimore UE shfaq një mekanizmo-marrëveshje e karakterit kontraktual e cila është pashikuar të lidhet me vendet e kësaj pjesë si aspirantë për tu anëtarësuar në UE. Marrëveshja e tillë quhet marrëveshja e Stabilizim Asocimit tani më e lidhur me shumicën e vendeve të Ballkanit përendimor. Rreth liberalizimit të vizave do të jetë një shpjegim i shkurtër dhe në mënyrë specifike do ti kushtohet rastit të Kosovës përveç asaj që përgjithësisht do shpjegohet për rajonin.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	REPUBLIKA E KOSOVËS DHE UE-ja, DIALOGU I PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIMIT, NEGOCIATAT PËR MSA, MEKANIZMAT E UE-SË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS Në kohën kur perspektiva evropiane hapet për gjithë ballkanin përendimor po në atë kohë hapej edhe për republikën e Kosovës në atë kohë nën administrim të përkohëshëm ndërkombëtar. UE-ja në mënyrë që mos ta lë jashtë proceseve integruese Kosovën dhe përshkka të rrethanave politike në atë kohë kishte themeluar një mekanizëm të veçantë dhe enkas për Kosovën që quhej Mekanizmi Përcjellës i Procesit të Stabilizim Asocimit. Me progresin e arritur nga republika e Kosovës e sidomos pas shpalljes së pavarësisë ky mekanizëm avancoi duke u shndërruar në Dialogun e Procesit të Stabilizim Asocimit për të avancuar në ditët e sotme deri në prag të hapjes së negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit. Gjithashtu në mënyrë të përgjithësuar do të flitet për mekanizmat e UE-së në Republikën e Kosovës.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	ÇËSHTJET AKTUALE NË UNIONIN EVROPIAN DHE REKAPITULIM I LËNDËS PARA MBAJTJES SË PROVIMIT Paraprakisht do të shpjegohen çështjet aktuale në Unionin Evropian dhe konform kërkesës së studentëve do të organizohet edhe një orë e veçantë që do ti kushtohet pyetjeve të studenteve rreth lëndës në përgjithësi. Gjithashtu studentët në këtë orë do të marrin edhe informacionet mbi organizimin e provimit përfundimtarë.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	TESTI PËRFUNDIMTAR
	PROVIMI PËRFUNDIMTAR

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: